



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 754/1Prot.

Tiranë, më 16 . 05. 2024

V E N D I M

Nr. 132, datë 16. 05. 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 97 Regj., datë 26.04.2024, të znj. L. B, në cilësinë e përfaqësueses së Shoqërisë “Hxxx” sh.p.k kundër Qendrës Kombëtare të Biznesit, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar ankesës së depozituar pranë Komisionerit, subjekti ankues parashtron se: Në datën 13.02.2024, Shoqëria "Hxxx" sh.p.k, ka kryer aplikimin CN-253681-02-24 për ndryshim adrese, e cila është refuzuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit me pretendimin se nuk është ndryshuar gjendja e ortakërisë në regjistrin e pronarëve përfitues, gjendje e ndryshuar në datë 29.10.2021. Gjatë kësaj periudhe e në vazhdim janë bërë shumë veprime si vendim i ortakëve, depozitim bilanci dhe nuk ka pasur asnjë njoftim nga ky institucion. Në këto kushte i jemi drejtuar QKB me shkresë datë 20.02.2024 për të pasur një sqarim dhe informacion të mëtejshëm lidhur me këtë çështje. Me shkresën nr.3790/1 datë 27.02.2024 të QKB bëhemi me dije së Shoqëria "Hxxx"

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

sh.p.k duhet të bënte ndryshimin e pronarëve përfitues pa penalitet deri në datë 30.06.2022, mospërmbushja e detyrimit shoqërohet me penalitet 400.000 all dhe në shteruese të shkresës nënvizohet se subjektet duhet të shlyejnë detyrimet e më pas vijohet me aplikim për ndryshim dhe përditësim të të dhënave në regjistrin e pronarëve përfitues RPP. Në këto kushte me shkresën tonë nr.1713 prot., datë 18.03.2024 i jemi drejtuar QKB për të marrë njoftimin e vlerësimit për të ndjekur procedurat administrative dhe gjyqësore. Me shkresën nr.1713/1prot., datë 04.04.2024 të QKB, marrim përgjigje se gjenerimi i kundravajtjes administrative nuk rezulton sepse subjekti nuk ka aplikuar për përditësimin e të dhënave. Në këto kushte nga ana jonë në mungesë të njoftimit zyrtar të detyrimeve nga QKB, dokument bazë për ndjekjen e të gjitha procedurave të ankimit administrative dhe gjyqësor po ju drejtohem ju si institucion për zgjidhjen e problemit të krijuar.

Masat që kërkohen të merren nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është zgjidhja e situatës.

- Pas pranimit të ankesës së depozituar në rrugë postare pranë Komisionerit, subjekti ankues është kontaktuar nga specialistja e Drejtorisë së Pritjes së Ankesave nëpërmjet telefonit, dhe i është kërkuar të plotësojë kriteret formale të ankesës, të depozitohet informacionin e dokumentacionin provues të deklarimeve të saj.

Në përgjigje të kërkesës të mësipërme, subjekti ankues ka dërguar informacionin e aktet bashkëlidhur tij, nëpërmjet e-mailit datë 29.04.2024.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”*, si dhe *“Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”*²

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se *“diskriminimi”* do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

² Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohej vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike të kësaj shoqërie.

Dokumentimi është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Në këtë kontekst, Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e subjektit ankues për trajtim të pabarabartë apo të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e Qendrës Kombëtare të Biznesit vijnë për shkakun e pretenduar, duhet që fillimisht ky shkak të jetë provuar e dokumentuar para KMD-së, si shkak i njohur e parashikuar nga LMD-ja.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh³. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohej mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh⁴.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e

³ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’*, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

⁴ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Diskriminimi⁵ karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën subjekti ankues nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedon atë.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues ka ngritur pretendime për trajtim të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e subjektit kundër të cilit ka paraqitur ankesën pranë KMD-së, Qendrës Kombëtare të Biznesit, duke cituar se diskriminohet për “çdo shkak tjetër”.

Përsa i takon pretendimit të subjektit ankues për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, nuk jep asnjë shpjegim konkret për shkakun e pretenduar të diskriminimit apo të vëri në dispozicion prova të cilat justifikonin se e mbartë këtë shkak, në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, nuk plotëson elementët e nevojshëm të kërkuar për përcaktimin e justifikimit të “shkakut” sipas LMD-së.

Në kuptim të LMD-së, “*Shkak i mbrojtur është një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.*”⁶

⁵ “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

⁶ <https://ëëë.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

Lidhur me sa më lart, si dhe me shpjegimet që jep subjekti ankues lidhur me faktin se nga ana e Qëndres Kombëtare të Biznesit nuk i është vënë në dispozicion njoftimit zyrtar i detyrimeve nga QKB, që ka sjellë si pasojë mosveprimet e tjera proceduriale administrative të këtij institucioni, Komisioneri vlerëson se, përmbushja e detyrimeve që Shoqëria ka ndaj QKB dhe anasjelltas, e cila shkon në përputhje me objektin e veprimtarisë së këtij institucioni, të sqaruara dhe në kthimet e përgjigjeve të kthyera nga QKB, nuk përbën një “shkak të mbrojtur” sipas LMD-së, në kuptimin që t’i kenë dhënë subjekti ankues një “status” apo t’i kenë veshur cilësi personale apo karakteristika të identifikueshme, të dallueshme individuale. Përmbushja e detyrimeve që shoqëria ka ndaj institucionit të QKB-së, apo kundërshtimi i veprimeve dhe procedurave që janë ndjekur prej saj, duhet ti adresohet institucioneve më të larta hirarkike për të vlerësuar nëse janë në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit në bazë të cilit ushtrojnë funksionet e tyre.

Komisioneri vëren se, arsyetimi i përdorur nga subjekti ankues lidhur me veprimet/mosveprimet e QKB, mund të lidhen me ligjshmërinë apo jo të veprimeve, apo vërtetësinë e argumenteve të dhëna prej QKB, por që nuk lidhen me cilësitë e karakteristikat e identifikueshme të subjektit ankues në kontekst të shkakut të mbrojtur sipas LMD-së.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i subjektit ankues për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, sipas kuptimit të LMD-së, nuk rezulton i provuar bazuar në provat e depozituara prej saj

Subjekti ankues nuk parashtron e argumenton bindshëm me fakte e prova, se mbart ndonjë shkak sipas kuptimit të LMD-së, mbi të cilin të mund të vijohej me hetimin e ankesës, nëse është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të diferencuar nga ana e QKB, krahasuar me persona të tjerë juridik/fizik, trajtim i cili të jetë motivuar pikërisht nga “çdo shak tjetër”, i provuar prej saj.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse:ç)nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues znj. L B, në cilësinë e përfaqësueses së Shoqërisë “Hxxx” sh.p.k kundër Qendrës Kombëtare të Biznesit, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA